

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT TË PROKURIMIT
PUBLIK PËR VITIN 2019

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur Komisionin e Prokurimit Publik si organin më të lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligj;

Duke vlerësuar si shumë të rëndësishëm për KPP-në paanësinë në vendimmarrje, transparencën, efikasitetin, si dhe mbrojtjen e interesave të ligjshme të operatorëve ekonomikë nga veprimet apo mosveprimet e autoriteteve kontraktore dhe në mënyrë të veçantë mbrojtjen e interesit publik;

Duke vlerësuar si shumë të rëndësishëm rolin që KPP-ja ka në rritjen e efikasitetit dhe të besueshmërisë në sistemin e prokurimit publik;

Vlerëson veprimtarinë e Komisionit të Prokurimit Publik, për vitin 2019, në drejtim të:

Trajtimit të një numri të konsiderueshëm prej 1141 ankesash në total, nga të cilat 1052 janë ankesat e paraqitura gjatë vitit 2019 dhe 89 ankesa të mbartura nga viti 2018;

Dhënies së 792 vendimeve themeli për 1141 ankesa të shqyrtuara gjatë vitit 2019 nga të cilat 729 vendime për ankimet e vitit 2019 dhe 63 vendime për ankesat e vitit 2018;

Rritjes së të ardhurave të derdhura në buxhetin e shtetit në vlerë 113,446,772 lekë nga tarifat e ankimit të operatorëve ekonomikë, për të cilët në fund të procesit administrativ është vendosur mospranimi i ankesës së tyre;

Dhënies së asistencës së nevojshme ligjore për aktet ligjore e nënligjore në fuqi, që prekin procedurat e prokurimit, koncesionet/PPP, ankandet e lejet minerare;

Bashkëpunimit të vazhdueshëm me institucionet partnere ndërkombëtare, kryesisht i orientuar në organizimin e disa trajnimeve dhe aktiviteteve të shkëmbimit të eksperiencave, me synim rritjen e kapaciteteve profesionale të punonjësve të KPP-së për zhvillimet më të reja në mekanizmat e rishikimit administrativ të prokurimit publik në vendet e BE-së dhe rajon, si edhe me mënyrat dhe metodat më të mira të menaxhimit të institucioneve homologe.

Kuvendi kërkon që Komisioni për vitin 2020 të angazhohet në këto drejtime:

- Të publikohet në faqen e internetit të institucionit në fund të çdo viti lista e procedurave ankimese, të cilat janë ose ka përfunduar procesi gjyqësor, fondet limite të këtyre procedurave objekt ankimi;

- Të forcohen kapacitetet administrative të KPP-së duke e bërë totalisht funksionale strukturën e miratuar nga Kuvendi deri në fund të vitit 2020, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi;

- Për të gjitha rastet kur nga shqyrtimi i ankesave konstatohen shkelje në vendimet e autoriteteve kontraktore apo vonesa të këtyre të fundit në dërgimin e dokumentacionit, të marrë masa, sipas natyrës së shkeljes së konstatuar, duke i referuar Agjencisë së Prokurimit Publik për marrjen e masave administrative sipas ligjit;

- Të marrë masa për standardizimin e vendimmarrjes dhe bërjen publike të tyre, me qëllim rritjen e efikasitetit të shqyrtimit të çështjeve, garantimin e barazisë, si dhe sigurimin e transparencës;

- Nëpërmjet bashkëpunimit me Shkollën e Magjistraturës, të rritet bashkëpunimi me Gjykatën Administrative për sa i takon trajnimit të punonjësve të të dyja institucioneve, me qëllim aftësimin e tyre për të trajtuar çështje komplekse të prokurimit publik dhe për t'u përballur me numrin në rritje të ankimeve, në zbatim të rekomandimeve të lëna në progresraport;

- Të plotësohet Regjistri Elektronik i Ankesave me elementet shtesë të nevojshme, siç janë edhe lloji i procedurës dhe fondi limit për çdo procedurë prokurimi objekt ankimi;

- Të rishikohet rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik, të miratuar me VKPP nr. 596, datë 12.9.2018, duke marrë në konsideratë rekomandimin

e Kontrollit të Lartë të Shtetit, në përputhje me ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 9.7.2020.